



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

8 mars 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Prizrenit të gjej zgjidhje të qëndrueshme për problemin e ndriçimit publik

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë pjesës së dytë të muajit shkurt ka shqyrtuar angazhimet e qeverisë lokale në përmirësimin e shërbimeve komunale.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit përmes mekanizmave të krijuar në platformën e “EC Ma Ndryshe” për monitorimin online të transparencës komunale, janë pranuar ankesa nga qytetarët në lidhje me shërbimet elementare komunale, përkatësisht mungesën e ndriçimit publik. Të njëjtat brenga janë ngritur edhe nga grupe të ndryshme të qytetarëve në kuadër të takimeve që “EC Ma Ndryshe” i ka mbajtur me shtresat e ndryshme të shoqërisë, si pjesë e projektit “Qyteti Gjithpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”.

Banorë të rrugës së Ulqinit ankohen se ndriçimi publik në rrugët e kësaj lagjeje ka një vit që nuk funksionon. Shqetësimi i tyre lidhet me nevojën që nxënësit duhet të lëvizin patjetër në këto rrugë, në orët e mbrëmjes, ngase atëherë kthehen nga shkolla. Sipas tyre ekziston rreziku potencial që këta fëmijë të pësojnë nga automjetet që qarkullojnë në këtë pjesë të qytetit, ku nuk funksionojnë dritat publike.

Ndërsa përfaqësuesit e komunitetit të grave, të moshuarve dhe të rinjve e kanë paraqitur si shqetësim serioz mos funksionimin e duhur të ndriçimit publik, në lagjet e qytetit dhe ato periferike. Ata druajnë se kjo gjendje ka ndikim edhe në sigurinë e përgjithshme. Lagjet që përballen me këtë problem sipas këtyre grupeve janë “Bajram Curri”, “4 Kullat” në Bazhdaranë, “Ortakolli 2”, “Petrova”, dhe lagje të tjera.

Gjatë një vëzhgimi të monitoruesve të EC Ma Ndryshe është vërejtur se problemi i ndriçimit publik është i pranishëm edhe në lagjet “Lakurqi”, “Jeta e Re” lagja “Arbana”, lagja “Hoqamahalla”, etj.

Në bazë të Raportit Vjetor Financiar për vitin 2012, komuna e Prizrenit ka borxhe të papaguara për shërbimet komunale. Në pasqyrën e faturave (obligimeve) të papaguara të komunës së Prizrenit thuhet se shifra e borxhit është 123 mijë euro.

Në këtë raport bëhet e ditur se për shërbimet komunale në vitin 2012 janë shpenzuar 803 mijë euro, respektivisht 519 mijë euro për rrymë, që është shumë më e madhe se shpenzimet e rrymës në vitin 2011 që kanë qenë 399 mijë euro dhe në vitin 2010, 375 mijë euro.

EC Ma Ndryshe duke adresuar shqetësimet e banorëve të lagjeve e moshave të ndryshme, i bën thirrje ekzekutivit komunal që në afatin sa më të shkurtër t’i kryej obligimet që ka ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës, në mënyrë që të kthehet ndriçimi publik në të gjitha rrugët e Prizrenit.

EC Ma Ndryshe rekomandon qeverinë komunale dhe në veçanti Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Komitetin për Politikë e Financa që gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit apo rishikimit të buxhetit të kenë kujdes në planifikimin e linjave buxhetore dedikuar për shpenzimet komunale, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për çështjen e ndriçimit publik.

EC Ma Ndryshe i drejtohet me apel edhe Policisë së Kosovës që të merr parasysh shqetësimet e qytetarëve dhe të rris patrullimet në rrugët e qytetit, ku përkohësisht nuk funksionon ndriçimi publik.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*